



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.159/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Rafet Haxhaj, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Vllastimir Dimiq anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Cernogorska Demokratska Stranka (CDS), paraqitur kundër vendimit të Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike (ZRPPC)- (KQZ) , ne lidhje me gjobën e shqiptuar administrative, në seancën e mbajtur më 16.02.2011, mori:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar apeli i subjektit politik Cernogorska Demokratska Stranka (CDS).

#### ARSYETIMI

Më datë 15.02.2011 PZAP-i ka pranuar një apel nga subjekti politik (CDS) ndaj vendimit të ZRPPC rreth shqiptimit të gjobës administrative prej 500 €. Parashtruesi i apelit thekson se raporti i tyre financiar nuk ekziston dhe është 0.00 andaj KQZ-ja ka caktuar një gjobë administrative në vlerë prej 500 € përshkak të vonesës së dërgimit të raportit financiar prej 15 ditësh dhe për këtë arsye mund të ndodhë që subjekti ynë politik të suspendohet. Më tutje në apelin e parashtruar theksohet se vonesa në dorëzimin e raportit financiar ka ndodhur për arsye se CDS-ja nuk ka pasur kurrfar shpenzime financiare gjatë fushatës zgjedhore dhe se ne jemi një parti shumë e vogël dhe nuk kemi kurrfar donacione ashtu që edhe jemi vonuar në dorëzimin e raportit financiar për shkak të arsyeve financiare dhe fizike. Prandaj suspendimi i partisë demokratike malazise do te ndikonte drejtpërdrejt negativisht në komunitetin e malazezëve të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira dhe për këtë arsye kërkojmë nga ju që ta anuloni vendimin e KQZ-së.

Lidhur me rastin në fjalë, PZAP-i me datën 15.02.2011 me shkresën me nr 159/2 e njoftoi ZRPPC-në për apelin e ushtruar në PZAP ndaj vendimit të saj rreth shqiptimit të gjobës administartrive.

PZAP-i pranoi përgjigjen nga ZRPPC-ja shkresën me nr 667 të datës 16.02.2011 në, në të cilën thuhet se subjekti politik CDS ka dorëzuar Raportin e deklarimit financiar për shpenzimet e fushatës së subjektit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës, të 12.12.2010 me datën 10.02.2011 në afatin e ndëshkueshëm me gjoba administrative. Prandaj më tutje theksohet se arsyetimi i subjektit në fjalë nuk qëndron, sepse ky subjekt politik është gjobitur në pajtim me nenin 6.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 12/2009 Kufizimi i shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar, për dorëzim me vonesë të Raportit të Deklarimit Financiar, sepse këto obligime janë përcaktuar edhe me nenin 40.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 12/2009

Sipas Nenit 40.1 të LZP-se dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 12/2009, Neni 3.1 thekson se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit politik, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i publikimit financiar për fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzete e pese (45) ditë kalendarike pas dites se zgjedhjeve;*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lëndes gjeti se:

#### **-apeli është i pabazuar**

PZAP-i konstaton se apeli i vendimit të ZRPPC-se të datës 11.02.2011 nga subjekti politik CDS, është i pabazuar për faktin se nga pretendimet ankimore të ankuesit si dhe nga shkresat e lëndës si dhe nga përgjigja e ofruar nga ZRPPC-ja shihet se ankuesi në fjalë e ka dorëzuar me vonesë, jashtë afatit ligjor Raportin e Deklarimit Financiar të fushatës së subjektit politik, obligime këto të përcaktuara me nenin 40.1 të LZP-së dhe nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 12/2009.

Prandaj për keto arsye si dhe në kuptim të nenit 115.1 të LPZ-se, PZAP mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 159/2011 më datën 16.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhaj**

